

XIV. PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

14.1. INSTALIMI DHE AKTIVITETET E TIJ

Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve, ID 7.12, pika a. Procesi i tharjes së shpejtë të bojës së stampimit/printimit me anë të ajrit të nxehtë. Leje Mjedisi tipi B.

Projekti konsiston në zhvillimin e aktivitetit të prodhimit të çantave të letrës, plastikes dhe tekstili për ambalazhim të produkteve ushqimore dhe jo ushqimore. Produktet që përdoren në këtë linjë prodhimi përbëhen tërësisht prej materialesh biologjikisht të dekompozueshëm.

Objekti ndodhet në Qarkun Tirane, Njesia Administrative 6, Rruga "Llazar Xhajanka", Ndërtesa Nr.20, ish Kombinati i Tekstileve, me sipërfaqe të mjediseve të punës 6500m² me kapacitet 3.5 ton/dite produkt canta letrë, me Nr. pasurie 7/593, Zona Kadastrale Nr. 8230

PERSHKRIMI I VEPRIMTARISE QE ZHVILLOHET

AKTIVITETI: Linje prodhimi të çantave prej letrë, plastike dhe tekstili.

Adresa: Adresa: Rruga "Llazar Xhajanka", Ndërtesa Nr.20, ish Kombinati i Tekstileve; Tirane, te ndodhur ne Zona kadastrale 8230, Pasuria nr 7/593, Tirane.

Subjekti: "FORM PACKAGING " Sh.p.k, me NIPT: L41420009R

Administrator: Z. Rudina Kumbulla

Objekti ku zhvillohet aktiviteti për Linje prodhimi çantave prej letrë, plastike dhe tekstili të shoqërisë "FORM PACKAGING" shpk është i pozicionuar në zonën e Ish Kombinati Tekstileve, Adresa: Rruga "Llazar Xhajanka", Tirane. Kompania FORM PACKAGING Shpk. Person Juridik, zhvillon aktivitetin në fushën e Prodhim, të çantave prej letrë dhe plastike, dhe çantash prej tekstili, i regjistruar pranë Qendres Kombetare të Biznesit me NIPT: L41420009R, që prej datës 20.02.2014. Subjekti në fjale është i pajisur me Leje Mjedisi tipi C Nr Serial: PN-7761-08-2014/2 dhe në zbatim të dispozitave ligjore, perkatesisht Ligjit Nr. 52/2020 datë 30.04.2020 për një ndryshim në Ligjin 10448 "Per Lejet e Mjedisit" do të kryejë procedurën e kalimit nga Leje Mjedisi tipi C në Leje Mjedisi tipi B.

Operatori e zhvillon aktivitetin në një sipërfaqe të mbyllur (godinë 1 kat), e cila është e shtruar me beton dhe plotëson të gjitha kërkesat për të zhvilluar këto aktivitete.

Objekti i vlerësimit të këtij raporti është aktiviteti i prodhimit të çantave letrë të personalizuar me logon si dhe me modelin (formatin) që porositen enksa për kompani të ndryshme. Produktet që përdoren në këtë linjë ambalazhimi përbëhen tërësisht prej materialesh biologjikisht të dekompozueshëm. Një nga risitë e reja të tregut shqiptar ofruar nga Form packaging sh.p.k. Çantat janë tërësisht prej letrë duke përfshirë edhe dorezat. Letra është shumë rezistente dhe varion në gramaturat nga 80 gr deri në 170gr. Çanta është e përbërë nga letra dhe është tërësisht

e dekompozueshme. Ndersa dorezat jane prej pambuku. Lista e disa nga produkteve kryesore te linjes se prodhimit te ambalazhit te kartonit:

1. Çanta letre.
2. Letra paketimi.
3. Letra ushqimore.
4. Çanta plastike.

Nga ushtrimi i ketij aktivitetit nuk ka ndikime ne mjedis, gjithashtu nuk ka as mbetje te rrezikshme, te cilat prodhohen nga ky aktivitet.

Kjo permbledhje joteknike e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, parashikon ndikimet ne mjedis nga aktiviteti i linjes për prodhim te cantave letre dhe zbatimi te kushteve teknike.

Ky aktivitet, zhvillohet ne Qarkun Tirane, Njesia Administrative 6, ish Kombinati i Tekstileve, me sipërfaqe te mjediseve te punes 6500m².

Teknologjia e prodhimit te kartonit dhe letrës për ambalazhe e canta

- Procesi teknologjik për prodhimin e kartonit të valëzuar. Linja e marrë në studim zotëron një proces teknologjik për prodhimin e cantave që arrihet nga përpunimi i lëndës së parë të pastër letër për ambalazhim, si dhe letra paketim për ushqime që arrihet edhe kjo nga përpunimi i lëndës së parë të pastër letër për ambalazhim.
- Për këtë përdoren teknologji me procese teknologjike të gatitjes së letrës për canta te fomateve te ndryshme që arrihet nga përpunimi i lëndës së parë të pastër letër për ambalazhim.
- Si lëndë të parë shërbejnë edhe bojrat ekologjike që përdoren në rastet e vendosjes se logove te subkekteve kerkuese të cantave te letrave për ambalazhe, ku merren letra ekologjike të certifikuara.
- Gjatë proceseve formohen mbetje të letrës pas përpunimit të tyre për ambalazhim te çantave. Produkti final canta e qese letre arrihen te palosen me duar ose manuale.
- Gjithë procesi teknologjik dhe ai manual nuk përdor as temperature të mesme as edhe të larta, ku të kemi formim të avujve që të kërkojnë oxhaqe shkarkimi.
- Nuk përdoren as sasi ujore që kërkojnë shkarkime.

E vetmja mbetje që krijohet është ajo e letrës dhe kartoneve ku ato sistemohen sipas një kontrate me kompani përkatëse.

Operacionet e impiantit te ambalazhimit te letrave

1. Makineria e stampimit te letres;
2. Makineria e prerjes, e markes Biagioni;
3. Paketimi;
4. Magazina e lendes se pare;
5. Njesit e sherbimeve mbeshtetese

PËRSHKRIMI I PROÇESEVE TË PUNËS

Në realizimin e ketij aktiviteti, proceset kryesore teknike janë:

- **Procesi i vijeimit të letrës**

Procesi realizohet në makinerinë e vijëzimit.

Ne kete makineri kryhet vijeziimi i letres sipas permasave te vensosur ne skeden e punes ose urdherin e punes. Makina e vijezimit eshte e modelit IBERICA JR-105-F-300".

Pas kryerjes se procesit te vijezimit, behet prerja ne thike, Makina tip Che.Ba.

➤ **Procesi i prerjes së letrës**

Procesi realizohet në makinerinë e prerjes së letrës. Modeli i makinerise eshte Che.Ba.

Letra pritet ne kete makineri ne baze te formatit te percaktuar ne skeden e punes ose urdherin e punes. Me tej pas realizimit te procesit te prerjes se letres vazhdohet me:

➤ **Procesi i stampimit ose ngjyrimit te letrës apo logimit te letres**

Ky proces realizohet në makineritë e stampimit te tipit Roland. *FORM PACKAGING* procesin e stampimit e realizon ne makineri te stampimit. Ne raste te caktuara per disa pune kryhet procesi i stampimit me stampe te nxehte.

- Offset – per permasat 70*100 cm , formati i madh

➤ **Procesi i Plastifikimit**

Per porosi te caktuara realizohet procesi i plastifikimit te letres se paprere me kolle, process i cili realizohet ne makinerine e plastifikimit e modelit Paper plast dhe eshte automatike. Plastifikimi eshte dy llojsh Opaco (pa shkelqim) dhe Lucido (me shkelqim).

➤ **Stampimi i nxehtë**

Procesi realizohet në makinerinë e stampës së nxehtë, Allmalie Smart Scan, i cili perdore ne menyre te kombinuar energjine elektrike (per arritjen e temp. se nevojshme teknologjike dhe funksionimin e paisjeve elektronike, si dhe ajrin e komprimuar per funksionimin e presave). Kjo makine ndihmon ne uljen e skarcitetit. Ne baze te kerkesave nga klient te ndryshem mbi nje nr cantash aplikohet procesi i stampimit te nxehte, per kryerjen e ketij procesi perdoren makineri gjysem automatike. Ky proces bazohet ne metoden e transferimit ne saje te nxehtesise me ane te presionit te ushtruar mbi shirit, i cili permban lenden e transferueshme.

➤ **SEKTORI I MANIFAKTURES – Mbyllja manuale e çantave**

Pas perfundimit te proceseve te sipershenuara kalohet ne Sektorin e Manifaktures. Ne kete sector te gjitha proceset e punes jane manuale si palosja e pare, tubolare, ngjitja anesore, kthimi i fundeve, ngjitja e fundeve, vendosja e dorezave etj.

Procesi i fundit eshte paketimi ne kuti kartoni dhe kontrolli i cilesi se cantave. Cantat qe prodhohen ne kete fabrike jane me dhe pa plastifikim.

Produktet e e cantave te Letres dhe kartonit

Si për çdo produkt tjetër edhe për këto produkte procesi bazë është prerja e letres, e cila realizohet në makinerinë e sipërcituar të prerjes. Me tej në varësi të produktit, proceset vazhdojnë si më poshtë :

- Makineria Flexo – në këto makineri (Demag) kryhet procesi i stampimit ose logimit të letres sipas porosise.

Në këto makineri realizohen produkte si: tabaka, leter veline etj

- Manzoni - në këto makineri kryhet procesi i stampimit ose logimit të letres si dhe prerja dhe ngjitja e qeseve të letres.

Radha e punës parashikohet të jetë si më poshtë:

- 1) Përgatitja e ambjenteve të impiantit;
- 2) Kontrolli i sistemit të sigurisë;
- 4) Kontrolli i sistemit të mbrojtjes nga zjarrit;
- 5) Menaxhim të mbetjeve të letres.

EFKËTET MJEDISORE TË NJOHURA

të cilat kanë lidhje me kryerjen e aktiviteteve në instalim, dhe përshkruani masat ekzistuese ose të propozuara që synojnë reduktimin e ndikimit në mjedis.

Ndikimet në popullsi

Ndikimi në popullsi mund të jetë i formave të ndryshme, gjatë funksionimit të impiantit aksidentimi i banorëve nga mjetet e transportit në rrugë, aksidentimi i punëtorëve gjatë punës është një nga rreziqet kryesore sidomos nëse ata janë të pa trajnuar.

Lloji i ndikimit në shëndetin publik	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Krijimi i çfarëdo rreziku apo mundësie për dëmtimin e shëndetit të njerëzve				x
Krijimi i raportit të njerëzve me rreziqet e mundshme për dëmtimin e shëndetit publik				x

Ndikimet në Pejzazh

Nuk ka ndikime në pejzazh, sepse zona në të cilën ndodhet objekti, nuk do të ketë ndikime të pjesshme, gjatë periudhës së funksionimit. Pejzazhi nuk do të ndryshojë, mbasi ka ekzistuar si ishkombinati i tekstitit Tiranë. Mbetjet e ngurta do të mblidhen përkohësisht në kazanët përkatës, në mënyrë që të jenë të gatshme për tu tërhequr nga Bashkia.

Lloji i ndikimit në tokë	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Ndryshime topografike të terrenit				x
Prishja e tokës bujqësore				x
Ndotja e tokës nga rrjedhjet				x

Ndotja e tokës nga mbetjet e ngurta				x
Ndotja e tokës nga depozitimet e llumrave				x

Ndikimet nga Shkarkimet në Ajër

Ndikime në shkarkimet në ajër mund të vijnë, si nga PM10 dhe nga ngarkesat gjatë qarkullimit të automjeteve. Shkarkime të tjera të gazta si djegie karburantesh etj., nuk do të ketë nga ky aktivitet, për faktin se makinerite e linjes funksionojnë me energji elektrike.

Lloji i ndikimit në cilësinë e ajrit	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Ndotja e ajrit				x

Ndikimet e zhurmave gjatë punës

Dihet që gjatë funksionimit të impiantit do të kemi rritje të nivelit të zhurmave por brenda normave të zonave industriale dhe orarit të përcaktuar sipas ligjit shqiptar, si pasojë e funksionimit të makinerive të prodhimit të ambalazhimit të letres.

Lloji i ndikimit në ndotjen nga zhurmat	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Rritja e nivelit ekzistues të zhurmave				x
Rritja e nivelit të zhurmave, si rezultat i aktivitetit dhe makinave			x	
Rritja e nivelit të zhurmave për njerëzit				x
Niveli më i lartë i zhurmave për kafshët				x

Ndikime në transport

Do të ketë ndikim në rrugë, sepse do të shtohet aktiviteti i makinave, kur bëhet furnizimi me lende të pare dhe largimin e mbetjeve të letres për riciklim nga kompania e kontraktuar.

Lloji i ndikimit në qarkullim dhe transport	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Shtime të rëndësishme të qarkullimit të automjeteve			x	
Pakësime të vendqendrimeve të automjeteve apo nevoja për vendqendime të reja				x
Ndikime të rëndësishme në sistemin e komunikacionit				x
Ndryshime në qarkullimin apo lëvizjen e njerëzve				x

Ndikime në rrugët lokale

Lloji i ndikimit në interesin publik (infrastruktura)	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo

Ndryshimi i destinacionit të aktivitetit do të ketë nevojë për ndryshim në këtë fushë të interesit publik				x
Konsum te Energjise elektrike			x	
Sistemin e komunikacionit				x
Sistemin e kanalizimit të ujrave të zeza dhe të bardha				x
Sistemin e ujësjellësit				x
Mbetjet e letres dhe kartonit dhe riciklimi i tyre			x	

Ndikimet në Trashëgiminë Kulturore dhe Arkeologjike

Ndikime në këtë aspekt nuk do të ketë, pasi në zonën përreth nuk ka zona me trashëgimi kulturore dhe arkeologjike.

Lloji i ndikimit për trashëgiminë kulturore	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Ndryshime apo dëmtime të zonave arkeologjike apo me vlerë historike e kulturore				x

Ndikimet në Florë e Faunë

Zona në të cilën funksionon linja është një zonë industriale dhe e varfër përse i përket florës dhe faunës.

Lloji i ndikimit në florën dhe faunës	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Shkatërrimi i rëndësishëm i habitateve natyrore				x
Rrezikimi i ndërhyrjes në bimët e ujit				x
Ndërtimi i rrugëve të reja që kalojnë përmes zones së virgjër				x
Përçarje apo izolim të habitateve të egra				x
Interferencë midis rrugës natyrore të emigrimit të sisorëve				x

Ndikimet në ujë

Lloji i ndikimit në ujë	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Trajtimi i ujrave të ndotur				x
Ndotja e ujit prej pluhurit, hidrokarbureve, derdhjeve aksidentale dhe substancave të tjera				x
Ndikimi sekondar në ndotjen e ujit për toka bujqësore, ujrat nëntokësore, etj.				x
Modifikim në drenazhimin e ujrave natyrore				x
Ndotja e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga llumrat				x

Ndikimet në klimë dhe ajër

Ndikimet në klimë nuk do të ketë, sepse nuk do të prodhohet CO₂.

Ndikimet në tokë

Lloji i ndikimit në përfitimin e tokës	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo

Shkatërrim banesash				x
Ndryshime të rëndësishme në programet për të ardhmen e përdorimit të tokës				x
Rivendosje banesash				x
Shpronësime të tokës				x

Ndikime dytësore që lidhen me projektin

Lloji i ndikimit në energji	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Përdorim i sasive të mëdha të karburantit për energji				x
Rritje të rëndësishme të kërkesave për burime ekzistuese energjisë apo kërkesave për tipe të reja të energjisë				x

14.2. NDIKIMET POZITIVE TË PROJEKTIT

Ndikimet Pozitive

Edhe pse është e pa evitueshme, që në rajon të shfaqen disa ndikime negative mjedisore e sociale, projekti do të bëjë që:

- të ketë punësim të vazhdueshëm;
- të sigurojë investime të drejtpërdrejta në komunitetin lokal;
- ndikimet mjedisore që identifikohen të eliminohen, reduktohen ose zbuten.

Duke patur parasysh vlerat jo të mëdha të territorit në gjëndjen aktuale, mendohet se kompensimet dhe ndikimet e tjera pozitive, si punësimet, përmirësimet në infrastrukturë marrin një rëndësi të veçantë për komunitetin e rajonit. Këto ndikime nxisin edhe komunitetin për mbështetjen e investimeve.

Masa të tjera të planifikuara në përputhje me parimet e përgjithshme që rregullojnë detyrimet themelore të operatorit, dmth:

- janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre;*
- janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme*

14.3. PËRFUNDIME

1. Nga impianti nuk shkaktohet asnjë ndotje e konsiderueshme, në veçanti me anë të zbatimit të praktikave më të mira;
2. Impianti punon dhe menaxhon parametrat që sigurojnë mbrojtjen e tokës;
3. Impianti punon dhe menaxhon parametrat që sigurojnë mbrojtjen e ujërave nëntokësore;
4. Impianti punon dhe menaxhon parametrat që sigurojnë menaxhimin e përshtatshëm të mbetjeve të gjeneruara nga instalimi;
5. Kompania dhe studioja e realizimit të raportit Mjedisor për këtë impiant ka përcaktuar masat që duhen ndërmarrë për parandalimin e aksidenteve dhe minimizimin e pasojave të tyre;
6. Kompania dhe studioja e realizimit të raportit Mjedisor për këtë impiant ka përcaktuar kërkesat e përshtatshme për monitorimin e shkarkimeve, duke përcaktuar metodologjinë dhe frekuencën e matjeve, procedurën e vlerësimit, si dhe të sigurojnë se zotëruesi i lejes i jep AKM-së dhe ISHMPU-së të dhënat e kërkuara për të kontrolluar përmbushjen e kushteve të lejes së mjedisit të tipit B;

7. Studioja e realizimit të raportit Mjedisor për këtë impiant ka përcaktuar që operatori t'i sigurojë rregullisht AKM-së dhe ISHMPU-së rezultatet e vetëmonitorimit të shkarkimeve;
8. Studioja e realizimit të raportit Mjedisor për këtë impiant ka përcaktuar që operatori të informojë pa vonesë AKM-në dhe ISHMPU-në për çdo aksident, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore.

Edhe pse është e paevitueshme, që në Tirane të shfaqen disa ndikime negative mjedisore e sociale, projekti do të bëjë që:

- Të ketë punësim,
- Të sigurojë investime të drejtpërdrejta në komunitetin lokal;